

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Shukran Celina procesmbajtëse, në lenden penale kundër të akuzuarve E.S, nga fshati ..., Komuna e ..., për shkak të veprës penale të mashtrimit nga neni 261 par.1 të KPK-ës, I.S, nga ... dhe D.Q, nga fshati ..., Komuna e ..., për shkak të veprës penale legalizimi i përmbajtjes të pavërtetë në bashkë kryerje nga neni 334 par.1 lidhur me nenin 23 të KPK-ës, dhe G.B, nga ..., për shkak të veprës penale rastet e posaçme të falsifikimit të dokumenteve nga neni 333 par.1 të KPK-ës, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr. 192/2012 të datës 07.08.2012, pas mbajtjes të shqyrtimit kryesor publik në praninë e prokurorit të shtetit Beqë Shala, të akuzuarve, të dëmtuarve, mbrojtësve, me datë 29.12.2014 morri dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1.E.S, nga i ati Sh..., dhe nëna N..., me mbiemër të vajzërisë ..., i lindur me datë ... në fshatin ..., Komuna e ..., ku edhe jeton, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor në ndërtimtari, i martuar, baba i katër fëmijëve, i gjendjes së varfër ekonomike, boshnjak, shtetas i Republikës së Kosovës.

2.I.S, nga i ati A..., dhe nëna M..., me mbiemër të vajzërisë ..., i lindur me datë ... në fshatin ..., Komuna e ..., tani jeton në ..., rruga "...", nr...., ka të kryer shkollën fillore, punëtor, i martuar, baba i katër fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

3.D.Q, nga i ati S..., dhe nëna F..., me mbiemër të vajzërisë ... i lindur me datë ... në fshatin ..., Komuna e ..., ku edhe jeton, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor, i pamartuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

4.G.B, nga i ati M..., dhe nëna Sh..., me mbiemër të vajzërisë S..., i lindur me datë ... në ..., ku edhe jeton, rruga "...", pa numër, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

1.I akuzuari i parë E.S,

I.Në fillim të muajit mars të vitit 2011, në ..., në rrugën "...", nr...., pikërisht në shtëpinë e të dëmtuarit M.R, me qëllim për ti sjell vetës dobi pasurore e mashtron ose e sjell në lajthim të dëmtuarin, duke i fshehur faktet dhe me këtë shtynë që të veproj në dëme të pasurisë së tij në atë mënyrë që lidhin marrëveshje që i akuzuari të ndërtoj shtëpinë e të dëmtuarit M.R, dhe si kundër vlerë ti ipet automjeti i markës "Audi A4", pronë e H.K, në vlerë prej 12.500 Euro (dymbëdhjetëmijepesëqind Euro), si dhe 4.000 Euro (katërmijë Euro), të cilat janë dhënë kesh, mirëpo i akuzuari jo vetëm që nuk e ka përmbushur obligimin e tij, por automjetin e markës "Audi A 4", ja shet të akuzuarit të dytë I.S,

Këso dore ka kryer veprën penale të mashtrimit nga neni 261 par.1 të KPK-ës,

2.I akuzuari i dytë I.S dhe i akuzuari i tretë D.Q.

II.Me datën 04.11.2011, në ..., e vënë në lajthim qendrën e regjistrimit të automjeteve "...", në ..., në mënyrë që i akuzuari I.S ja jep dokumentet dhe ate lejen e qarkullimit të automjetit "Audi A4", letërnjoftimin e tij dhe një kopje të letërnjoftimit të pronarit të automjetit H.K, me qëllim që i akuzuari D.Q të bëjë regjistrimin e automjetit, edhe pse i njëjti ka qenë në dijeni që nuk ka pasur kontratë për shitje komisionarë nga ana e H.K, me të cilin rast i akuzuari D.Q shkon në NSH "...", blenë një kontratë për shtije komisionarë e më pas bënë regjistrimin e automjetit në fjalë, duke u pajisur me dokumente për regjistrimin e automjetit dhe targat e regjistrimit në emër të akuzuarit I.S.

Këso dore kanë kryer veprën penale legalizimi i përmbajtjes së pavërtetë në bashkë kryerje nga neni 334 par.1 lidhur me nenin 23 të KPK-ës,

3.I akuzuari i katërt G.B.

III.Me datën 04.11.2011, pa autorizim plotëson ndonjë letër apo formular të zbrazët në të cilën është vënë nënshkrimi i personit tjetër me të cilin krijon marrëdhënie juridike në atë mënyrë që e shet dhe e plotëson kontratën për shitje komisionarë nr. ... edhe pse nuk ka pasur autorizimin për nënshkrimin e kësaj kontrate nga ana e të dëmtuarit I.S.

Këso dore ka kryer veprën penale rastet e posaçme të falsifikimit të dokumenteve nga neni 333 par.1 të KPK-ës,

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 7, 41, 49 par.1 pika 1.1, 50, 51, 52, 73, 74, 75 dhe 76 të KPK-ës, te akuzuarve iu shqipton:

DENIM ME KUSHT

Të akuzuarit të parë E.S për veprën penale nën I. të dispozitivit

Ashtu që i vërteton dënimin me burg në kohë zgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 2 (dy) viteve, nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nëse e akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

Të akuzuarit të dytë I.S për veprën penale nën II. të dispozitivit

Ashtu që i vërteton dënimin me burg në kohë zgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 2 (dy) viteve, nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nëse e akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

Të akuzuarit të tretë D.Q, për veprën penale nën II. të dispozitivit.

Ashtu që i vërteton dënimin me burg në kohë zgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 2 (dy) viteve, nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nëse e akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

Të akuzuarit të katërt G.B, për veprën penale nën III. të dispozitivit.

Ashtu që i vërteton dënimin me burg në kohë zgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 2 (dy) viteve, nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nëse e akuzuari nuk kryen vepër të re penale

Obligohet i akuzuari i parë të paguaj shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe ate në emër të ekspertizës të ekspertit të ndërtimitarisë shumë prej 100 Euro (njëqind Euro), dhe obligohen të akuzuarit e tjerë që në emër të paushallit gjyqësor dhe ate secili veç e veç të paguajnë shumë prej 20,00 Euro. Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari H.K nga fshati ..., Komuna e ..., për realizimin e kërkesës pronësore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP.nr. 192/2012 të datës 07.08.2012, kundër të akuzuarve E.S, nga fshati ..., Komuna e ..., për shkak të veprës penale të mashtrimit nga neni 261 par.1 të KPK-ës, I.S, nga Prizreni dhe D.Q, nga fshati ..., Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale legalizimi i përmbajtjes të pavërtetë në bashkë kryerje nga neni 334 par.1 lidhur me nenin 23 të KPK-ës, dhe G.B, nga Prizreni, për shkak të veprës penale rastet e posaçme të falsifikimit të dokumenteve nga neni 333 par.1 të KPK-ës

Prokurori i shtetit Beqë Shala në fjalën e tij përfundimtar deklaron: se të pandehurit E.S I.S , D.Q dhe G.B kanë kryer veprat penale të cilët i vihet në barë të përshkuara në aktakuzë PP.nr.192/2012 kjo vërtetohet nga dëshmia e të dëmtuarve – dëshmitarëve M.R, H.K, B.B, B.H

si dhe dëshmia e ekspertit të ndërtimtarisë L.M. Nga dëshmia e të dëmtuarve dëshmitarëve M.R dhe H.K vërtetohet në detaje se si i pandehuri E.S me veprimet të tija që ta vë në lajthim të dëmtuarit M.R po ashtu edhe në veprimet e të pandehurve I.S dhe D.Q vërtetohet se që njëjtë pasi që marrin automjetin “Audi A 4” bënë legalizimin ose kryen veprën penale legalizimin e përmbajtjes së pa vërtet e sanksionuar me nenin 334 par. 1 lidhur me nenin 23 që lë të kuptohet se të dy të pandehurit I.S dhe D.Q këtë vepër penale e kryen në bashkëveprime. Po ashtu gjatë rrjedhjes së seancave të zhvilluara nga dëshmitar e lartë cekura vërtetohet se edhe në veprimet e të pandehurit G.B ekzistojnë elemente e veprës penale rastet e posaçme të falsifikimit të dokumenteve nga neni 333 par. 1 të KPK. Një gjendje e tillë faktike vërtetohet nga dëshmitarët – deklarata e të pandehurve të dhënë në prokurori me datë 11.04.2012. andaj propozoj që të njëjtë të shpallen fajtor dhe të dënohen si pas ligjit.

Mbrojtësi i të dëmtuarve H.K dhe M.R, avokat N.Q, kësaj gjykate i ka parashtruar fjalën përfundimtare me shkrim, me anë të parashtrësës, e cila do të jetë pjesë përbërëse e shkresave të kësaj lënde.

I dëmtuari H.K në fjalën e tij përfundimtare deklaron: që si palë e dëmtuar parashtron kërkesë pronësore juridike në vlerën e automjetit të tij të tipit “Audi A4”, ndërsa për shumën e saktë do të deklarohet në kontestin e rregullt civil.

I dëmtuari M.R në fjalën e tij përfundimtare deklaron: që si palë e dëmtuar nuk parashtron kërkesë pasurore juridike.

Mbrojtësi i të akuzuarit të parë E.S avokat V.O, fjalën e tij përfundimtare, i ka parashtruar gjykatës me shkrim, e cila do të jetë pjesë përbërëse e shkresave të kësaj lënde, dhe ka shtuar që fjala përfundimtare e përpiluar me shkrimë është bërë dje , dhe sot është krijuar një rrethanë e re, e cila sigurisht do të ndikoj në marrjen e vendimit përfundimtarë mbi dënimin sa i përket të mbrojturit tim E.S. Fjala është për një marrëveshje për kthimin e automjetit, në mesë të mbrojturit tim dhe të akuzuarit të dytë I.S, një kopje të së cilës sot i parashtroj gjykatës, pa nënshkrime dhe pa verifikim nga ndonjë organ. Konsideroj që si provë mundë të shërbejë kjo marrëveshje me nënshkrimin e të njëjtës nga palët sot para gjykatës , ndërsa sa i përket pjesës tjetër në tërësi mbetem si në formën me shkrimë.

Gjykata pranon një kopje të marrëveshjes së cekur në mesë të akuzuarit të parë E.St dhe të akuzuarit të dytë I.S , tani të nënshkruar në mes të palëve , e cila do të jetë pjesë e fjalës përfundimtare të përpiluar me shkrimë të mbrojtësit – avokat V.O.

I akuzuari i parë E.S , në fjalën e tij përfundimtare deklaron që mbështet në tërësi fjalën përfundimtar të mbrojtësit të tij avokat V.O si dhe marrëveshjen e arritur me të akuzuarin e dytë I.S.

I akuzuari i dytë I.S në fjalën e tij përfundimtare deklaron: unë në tërësi e kontestoj edhe njëherë veprën penale e cila më vihet në barë. Në raste se gjykata gjen prova me të cilën vërtetohet gjendja faktike e përshkuar në dispozitiv të aktakuzës, atëherë si rrethanë lehtësuese le të merr rrethanat familjare, personalitetin tim, pendimin tim që kam gabuar që kamë dorëzuar

dokumentacionin për regjistrimin e automjetit këtu të dëmtuarit H.K, por këtë e kamë barë duke i besuar këtu të akuzuarit të parë E.S, me të cilin kemi arritur një marrëveshje interne , të cilën e ka dorëzuar këtu mbrojtësi i të akuzuari E.. avokati i tij. Unë , deklaroj edhe njëherë që i vetmi gabim i imi është që kamë besuar shumë që automjeti është këtu i të akuzuarit E., dhe nga të cekurat më lartë , i propozoj gjykatës që të merre si rrethanat lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin.

I akuzuari i tretë D.Q në fjalën e tij përfundimtar deklaron: unë pendohem për veprimet e mija , të cilat veprime nuk i kam ditur që kanë qenë veprime kundër ligjore, kjo nga fakti që unë kur kam shkuar ta regjistroj automjetin e dajës tim këtu të akuzuarit I.S kam konsideruar që tërë procedurën paraprake e kamë kryer me rregull ngase po të kisha ditur që me këto veprime do të shkaktohet vepra penale, me siguri nuk do të kisha ndërmarr këto verime kjo është hera e parë që bije në konflikt me ligjin , jam person familjar , baba i një fëmiut, dhe i premtoj gjykatës që në të ardhmen do të përmbahen nga verime e tilla, e momenti dhe koha kur është shkaktuar vepra, është që kam qenë i moshës shumë të re andaj i propozoj gjykatës që të gjitha të cekurat më lartë , të merre si rrethanë lehtësuese me rastin e marrjes së vendimi mbi dënimin.

Mbrojtësi i të akuzuarit të katërt G.B avokat N.E në fjalën e tij përfundimtare deklaron: faktin e marrjes në pyetje të mbrojturit tim dhe faktin e ngritjes së aktakuzës e kam kundërshtuar të njëjtën nga rrethanat se mungon lidhje kauzale në mes të veprimeve të mbrojturit tim dhe pasojës së shkaktuar në praktikë.

Nga deklaratat e të pandehurve dhe si dhe të dëshmitarëve me asnjë provë nuk është vërtetuar se i mbrojturi im ka ndërmarr veprimet si në aktakuzë pasi asnjëri nga ata nuk siguron prezencën eventuale të tij me aktin e marrjes të bllanko kontratës nëpërmes të cilës është bërë shitje komisionarë të automjeti në pronësi të dëmtuarit.

I mbrojtur im është akuzuar vetëm se pronarin e shitjes komisionarë e ka djalë axhe ndërsa firma që ka ndërmjetësuar në shitje komisionarë në emër të mbrojturit tim por në fakt është regjistruar në emër të djalit të tij E.B.

Në vazhdim si provë gjykatës ja prezantoj një kopje të firmës komisionarë nga përmbajtja e të cilës vërehet se pronar është djali i të mbrojturit tim e jo ai vet.

Në kuadër të kësaj përfaqësuesi i akuzës është dashur që këtë kërkesë procedurale ta orientoj në vet pronarin e jo ndaj të mbrojturit tim se vetëm se është në afërsi gjaku me të.

Andaj i propozoj që pas shqyrtimit të provave të merr aktgjykim lirues komform 364 par. 1 pika 1.3 pasi që nuk është vërtetuar se i njëjti ka kryer veprën penale si në aktakuzë.

I akuzuari G.B në fjalën e tij përfundimtare deklaron: në tersi pajtohem dhe mbështes fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim avokat N.E.

Gjykata në shqyrtimin kryesor ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

I akuzuari i parë E.S,

I.Në fillim të muajit mars të vitit 2011, në ..., në rrugën “...”, nr...., pikërisht në shtëpinë e të dëmtuarit M.R, me qëllim për ti sjell vetës dobi pasurore e mashtron ose e sjell në lajthim të dëmtuarin, duke i fshehur faktet dhe me këtë shtynë që të veprojnë në dëme të pasurisë së tij në atë mënyrë që lidhin marrëveshje që i akuzuari të ndërtoj shtëpinë e të dëmtuarit M.R, dhe si kundër vlerë ti ipet automjeti i markës “Audi A4”, pronë e H.K, në vlerë prej 12.500 Euro (dymbëdhjetëmijepesëqind Euro), si dhe 4.000 Euro (katërmijë Euro), të cilat janë dhënë kesh, mirëpo i akuzuari jo vetëm që nuk e ka përmbushur obligimin e tij, por automjetin e markës “Audi A 4”, ja shet të akuzuarit të dytë I.S,

I akuzuari i dytë I.S dhe i akuzuari i tretë D.Q.

II.Me datën 04.11.2011, në ..., e vënë në lajthim qendrën e regjistrimit të automjeteve “...”, në ..., në mënyrë që i akuzuari I.S ja jep dokumentet dhe ate lejen e qarkullimit të automjetit “Audi A4”, letërnjoftimin e tij dhe një kopje të letërnjoftimit të pronarit të automjetit H.K, me qëllim që i akuzuari D.Q të bëjë regjistrimin e automjetit, edhe pse i njëjti ka qenë në dijeni që nuk ka pasur kontratë për shitje komisionarë nga ana e H.K, me të cilin rast i akuzuari D.Q shkon në NSH “...”, blenë një kontratë për shtije komisionarë e më pas bënë regjistrimin e automjetit në fjalë, duke u pajisur me dokumente për regjistrimin e automjetit dhe targat e regjistrimit në emër të akuzuarit I.S.

I akuzuari i katërt G.B.

III.Me datën 04.11.2011, pa autorizim plotëson ndonjë letër apo formular të zbrazët në të cilën është vënë nënshkrimi i personit tjetër me të cilin krijon marrëdhënie juridike në atë mënyrë që e shet dhe e plotëson kontratën për shitje komisionarë nr. ... edhe pse nuk ka pasur autorizimin për nënshkrimin e kësaj kontrate nga ana e të dëmtuarit I.S.

Gjykata pas vlerësimit të gjitha shkresave dhe provave të lëndës dhe ate të deklaratës të dëmtuarve H.K dhe M.R, deklaratave të akuzuarve, deklaratave të dëshmitarëve B.B, B.A dhe Sh.O, dhe deklaratës të ekspertit ndërtimtarisë L.M, si dhe provave materiale dhe ate të kontratës për shitje komisionarë nr. ... të datës 04.11.2011, ekspertizës me shkrim të ekspertit ndërtimtarisë lidhur me vlerësimin dhe mendimin për bazën e podrumit të objektit, si dhe shkresave tjera përcjellëse të lëndës, ka ardhur në përfundim se i akuzuari i parë E.S në mars të vitit 2012, në shtëpinë e të dëmtuarit M.R me qëllim për ti sjell vetës dobi pasurore e mashtron të njëjtin duke i fshehur faktet, në atë mënyrë që lidh marrëveshje që i njëjti do të ndërtoj shtëpinë të dëmtuarit M.R, dhe si kundër vlerë të ipet automjeti i markës “Audi A4”, pronë e H.K, në vlerë prej 12.500 Euro, si dhe 4.000 Euro të cilat janë dhënë kesh, por i akuzuari jo vetëm që nuk e ka përmbushur obligimin e tij, por automjetin e markës “Audi A4” ja shet të akuzuarit të dytë I.S, e të gjitha këto me qëllim të mashtrimit, dhe këtë e ka kryer me dashje sepse ka qenë i vetëdijshëm për veprimet e veta dhe ka dëshiruar kryerjen e saj. Në rastin konkret gjykata në këtë mënyrë edhe e ka vërtetuar përgjegjësin e tij penalo juridike. Nga kjo del që në veprimet e të akuzuarit të parë formohen të gjitha elementet e veprës penale që përbëjnë figurën e veprës penale dhe ate të mashtrimit nga neni 261 par.1 të KPK-ës, i akuzuari i dytë I.S dhe i akuzuari i tretë D.Q, me datë 04.11.2011 në Prizren, e kanë vënë në lajthim Qendrën e regjistrimit automjeteve “...”, në ..., në mënyrë që i akuzuari i dytë I.S, ja jep dokumentet dhe ate lejen e qarkullimit të automjetit “Audi A4”,

letërnjoftimin e tij dhe një kopje të letërnjoftimit të pronarit të automjetit H.K, me qëllim që i akuzuari i tretë D.Q ta bëjë regjistrimin e automjetit, edhe pse i njëjti ka qenë në ndieni që nuk ka pasur kontratë për shitjen komisionarë nga ana e H.K, me të cilin rast i akuzuari i tretë D.Q shkon në NSH "...", blen një kontratë për shitje komisionarë, e më pas bënë regjistrimin e automjetit të dëmtuarit, duke u pajisur me dokument për regjistrimin e automjetit dhe targat e regjistrimit në emër të akuzuarit të dytë I.S, e të gjitha këto me qëllim të legalizimit të përmbajtjes të pavërtetë, dhe këtë e kanë kryer me dashje sepse kanë qenë të vetëdijshëm për veprimet e veta dhe kanë dëshiruar kryerjen e saj. Pra në rastin konkret gjykata në këtë mënyrë edhe ka vërtetuar përgjegjësinë e tyre penalo juridike, nga kjo del se në veprimet e të akuzuarit të dytë I.S dhe të akuzuarit të tretë D.Q formohen të gjitha elementet e veprës penale që përbëjnë figurën e veprës penale të legalizimit të përmbajtjes të pavërtetë në bashkë kryerje nga neni 334 par.1 lidhur me nenin 23 të KPK-ës, i akuzuari i katërt G.B me datën 04.11.2011, pa autorizim plotëson formularin e zbrazët, në të cilin është vënë nënshkrimi i personit tjetër, me të cilin krijon mardhanie juridike, në atë mënyrë që e shet dhe plotëson kontratën për shitje komisionarë numër ..., edhe pse nuk ka pasur autorizim për nënshkrimin e kësaj kontrate nga ana e të dëmtuarit I.S, e këtë me qëllim të falsifikimit të dokumentit, dhe këtë e ka kryer me dashje sepse ka qenë i vetëdijshëm për veprimet e veta dhe ka dëshiruar kryerjen e saj, pra në rastin konkret gjykata në këtë mënyrë edhe ka vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo juridike, nga kjo del se në veprimet e të akuzuarit të katërt G.B formohen të gjitha elementet e veprës penale të figurës të veprës penale rastet e posaçme të falsifikimit e dokumenteve nga neni 333 par.1 të KPK-ës.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar në bazë të deklaratës të dëmtuarit M.R, i cili në shqyrtimin gjyqësor me datën 23.01.2014 deklaron, që në muajin mars të vitit 2011, kam lidhur marrëveshje gojore me të akuzuarin e parë E.S, për ndërtimin e shtëpisë sime, dhe ate në formë të karajapis, për shërbimet e kërkuara nga E., unë kam paguar duke i dhënë automjetin e markës "Audi A4", pronë e partnerit tim afarist H.K, në vlerë prej 12.500 Euro, si dhe i kam dhënë edhe 4.000 Euro të holla shtesë që në total bëjnë 16.500 Euro. Por i akuzuari E.. vetëm e ka rrënuar shtëpinë e vjetër dhe nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për ndërtimin e shtëpisë së re, për çka kam paguar shumën e cekur të hollave. I akuzuari për shumën e cekur ka ndërtuar vetëm bazamentin e shtëpisë dhe deri në pllakën e përdhesis dhe ate në sipërfaqe prej 40 metra katror, ndërsa asnjë veprim shtesë deri në pikën e kulmit sipas marrëveshjes më nuk ka ndërmarr. Në fund të muajit shtator të njëjtit vit unë kam shkuar në shtëpinë e të akuzuarit në fshatin ... për tu marurr vesh, por i njëjti më është shmangur, kur kam shkuar në shtëpinë e të akuzuarit, bashkëshortja e tij Z.S e ka ftuar policinë me pretendim që unë i kërcënohem këtu të akuzuarit dhe tërë familjes së tij. Lidhur me këtë unë kam dhënë edhe deklaratë në Stacionin policor në Sredckë, mirëpo unë vetëm kam kërkuar respektimin e marrëveshjes me të akuzuarin dhe realizimin e detyrave të tij nga marrëveshja jonë gojore. Duke e parë që i njëjti më ka mashtruar, me këto veprime të cekura më lart unë e kam lajmëruar rastin tek organet kompetente. Unë kam qenë shok që nga fëmijëria me të akuzuarin dhe e di që merret me punët e ndërtimtarisë dhe i kam ofruar ndërtimin e shtëpisë time. Unë kam pasur pëlqimin e H., ngase të njëjtin e kam edhe partner afarist, si dhe çelësi rezervë të automjetit kamë pasur ndërmend ti ja dorëzoj të akuzuarit E., pas ndërtimit të karajapisë sipas marrëveshjes. Konsideroj që tërë shpenzimet kanë qenë diku 1.000 Euro, këtë e them me mendimin të lirë. Pllaka e parë është 40 metra katror. Bazamenti ka qenë vetëm rrafshinë e objektit, dhe pa e rrafshuar bazamentin nuk ka mundur të filloj ndërtimin, andaj konsideroj se bazamentin e ka shtruar vetëm sa për rrafshim, andaj konsideroj që nuk e ka kaluar shumën prej 1.000 Eurove, këtë e them nga fakti se unë kam

paguar shpenzimet dhe material ndërtimor deri në pllakën e parë si ceka, duke përfshirë shpenzimet e rërës, zallit dhe materiale tjera ndërtimore. Sipërfaqja e përgjithshme ka qenë e paraparë sipas planit diku rreth 220 metra katror, duke përfshirë edhe dy pllakat e tjera dhe pjesën e kulmit.

I dëmtuari H.K, në shqyrtimin gjyqësor me datën 23.01.2014, deklaroi, unë me të dëmtuarin M.R, kam bashkëpunim afarist dhe i njëjti më ka kërkuar që në emër të ndërtimit të shtëpisë së tij të re ta lë si kundër vlerë automjetin tim të markës “Audi A4”, në vlerë prej 12.500 euro, si më ka thënë M., automjetin do të ja lë të akuzuarit E.S, i cili do të ndërtoj shtëpinë deri në kulm në formë të kara japisë. Unë si partner afarist i M., kam pranuar ofertën e M., por me rastin e marrëveshjes gojore me të akuzuarin E., jemi marrë vesh që automjetin e cekur do të ja përkthejmë të akuzuarit pas përfundimit të punëve sipas marrëveshjes. Unë për vetën time e kam pasur edhe çelësin rezervë të automjetit të cekur, dhe të njëjtin kemi pasur ndërmend ti ja japim të akuzuarit pas përkthimit, i cili përkthim do të bëjë si ceka më lart pas përfundimit të punëve. Nga i dëmtuari M.. kam kuptuar që këtu i akuzuari nuk e ka përfunduar punët e parapara me marrëveshje edhe përkundër të insistimit të M., e as nuk e ka kthyer automjetin e cekur. Unë në këtë çështje jam i dëmtuar në vlerë të automjetit të cekur në shumë prej 12.500 Euro. Unë personalisht letërnjoftimin tim nuk i kam dhënë askujt, automjetin tim ja kam dhënë si ceka më lart partnerit tim afarist këtu të dëmtuarit M.R.

Dëshmitari B.B, nga ..., në shqyrtimin gjyqësor me datën 23.01.2014, deklaroi: unë jam punëtor i cili punoj me mëditje, duke bartur dhe transportuar me traktorin tim. E.S më ka ftuar që të bartë zall dhe material tjetër ndërtimor. Unë kam shkuar dhe i kam kryer punën që më ka kërkuar E., e di që kemi rrënuar shtëpinë e vjetër të M., dhe pas grupimit për ndërtimin e themeleve është vendosur shtresa e parë e bazamentit. Unë nuk kam parë dhe as që kam njohuri deri ku është ndërtuar shtëpia e cekur, nga ana E... Përndryshe, e njoh edhe M., dhe si ka qenë marrëveshja në mes E.. dhe M.. unë nuk e di. Unë transportin me traktorin tim e kam kryer për pagesa ditore të mia. Në çfarë raporti, marrëveshje kanë qenë këtu i akuzuari E.. dhe i dëmtuari M., unë nuk kam qenë në ngjarje. Unë kam punuar edhe më herët me E..n, lidhur me punët e ndërtimit dhe me të njëjtin nuk kemi pasur probleme që vlen të ceket. Jemi marrë vesh me E..n, dhe rrënimi i shtëpisë ka zgjatur një ditë e gjysmë, me anë të bageritë është rrënuar shtëpia, ndërsa me traktorin tim unë i kam bartur mbetjet nga rrënoja. Unë jam paguar nga i dëmtuari M., në rastet kur i njëjti ka kërkuar shërbim prej meje lidhur me bartjen e materialit ndërtimor.

Dëshmitari Bajram Ajradini, në shqyrtimin gjyqësor me datën 29.01.2014, deklaroi: unë kam punuar si mbikëqyrës i punimeve të E.S, këtu i akuzuari i parë, në ndërtimin e shtëpisë të M.Rt. Nuk i di kushtet dhe rrethanat në të cilat është marrë vesh këtu i akuzuari E., për ndërtimin e shtëpisë të dëmtuarit M., por e di që ne kemi ndërtuar bazamentin e shtëpisë së re për M., në sipërfaqe prej diku rreth 60-70 metra katror, e çka ka qenë marrëveshja në mes të akuzuarit dhe të dëmtuarit, si dhe çmimi kontraktues unë nuk kam qenë në ngjarje. Trashësia e bazamentit të shtëpisë pas rrënimit ka qenë diku rreth 28,50 cm, kati i parë, gjegjësisht pllaka ka qenë mbi podrum në gjerësi më të madhe dhe atë 85,90 metra, duke pasur parasysh që nga themeli ka filluar zgjerimi i objektit. Unë personalisht kam qenë vetëm mbikëqyrësi i këtyre punëve, ndërsa pagesa më është bërë kohë pas kohe nga i akuzuari E., dhe mua personalisht më ka paguar diku rreth 200 Euro këtu i dëmtuari M.. Materiali ka qenë sipas të gjitha kriterëve të cilat i përshtaten ndërtimit. Dy anë kanë qenë muret e murosura ndërsa dy anë të tjera kanë qenë vetëm ndërtimi i

murit. Pllaka ka qenë ndërtim masivë në trashësi prej 12,15 cm. Pasi që kemi ndërpre punimin nuk kemi vazhduar me ndërtimin e objektit. Unë mjetet e mia të punës i kam marr ndërsa sa i përket E.. nuk e di a e ka marr. Mungesa e mjeteve materiale ka qenë shkak i ndërprerjes të ndërtimit të objektit. E di që ka qenë një marrëveshje në mes të akuzuarit dhe të dëmtuarit për ndërtimin e shtëpisë. Fjala ka qenë për një automjet të markës “Mercedes”, mirëpo nuk e kam parë automjetin “Mercedes”. Pas një kohe kam kuptuar që është ndryshuar marrëveshja dhe si automjet për ndërtimin e objektit në formë të pagesës ka qenë automjeti i markës “Audi”. As automjetin e parë e as automjetin e dytë nuk e kam parë. Unë kam qenë i paguar nga ana E.. nga 30 Euro në ditë, dhe ate për 36 ditë pune, duke përjashtuar edhe shumën prej 200 Eurove që mi ka dhënë M... Duke llogaritur që një metër katror është diku rreth 80-90 Euro për metër katror, e duke pasur parasysh që bazamenti ka qenë diku rreth 65,70 metra katror si dhe pllaka e parë në sipërfaqe prej 85-90 metra katror e sipërfaqja e tërësishme është diku rreth 150 metra katror, konsideroj që shpenzimet sipas kësaj llogarie janë diku rreth 15.000 Euro sipas bindjes time të lirë. Sipas mendimit tim të lirë shpenzimet e përgjithshme kanë marr shumën diku rreth 18.000 Euro, duke pasur parasysh faktin që shtëpia e vjetër e cila është rrënuar, dhe në vendin e të cilës është dashur të ndërtohet shtëpia e re nuk ka pasur podrum, e këtu i dëmtuari M.. ka kërkuar edhe podrumin.

Eksperti i ndërtimtarisë L.M në shqyrtimin gjyqësor të datës 10.04.2014, deklaroi, unë në cilësinë e ekspertit kam përpiluar dy ekspertiza lidhur me këtë çështje penale. Qëndroj në tërësi pranë të dhënave në ekspertizën e parashtruar gjykatës me datën 10.12.2014 dhe në aneksin e ekspertizës dhe ate raportin shtesë të datës 20.03.2014. Në kalkulimin e çmimit të parashtruar në ekspertizë është përfshirë edhe vendosja e pllakës së parë, e cila pllakë është në sipërfaqe të përgjithshme prej 86,04 metra katror, ndërsa bazamenti i objektit është diku rreth 55 metra katror, e kjo ka ndodhur për shkak që me rastin e vendosjes së pllakës e parë është bërë vendosja ma e madhe se bazamenti. Me rastin e shikimit të objektit, shihet se tereni para objektit nuk është i pjerrët, andaj mund të konkludoj që vështëresit kanë ekzistuar për shkak të rrugët të ngushta deri në çasjen në objektin kontestues, andaj edhe ka pasur vështëresit për transportimin e materialeve për ndërtimin e objektit. Eksperti kërkon shpenzimet e ekspertizës dhe të raportit shtesë si dhe për prezencën në dy shqyrtime gjyqësore në shumë prej 200 Euro.

Dëshmitari Sh.O, në shqyrtimin gjyqësor të datës 30.09.2014, po më kujtohet ngase unë regjistroj automjete për çdo ditë, dhe me këtë veprimtari merrem tash e 15 vite, nuk ka qenë prezent as G.B e as kush tjetër, unë mire me sigurimin e automjeteve, dhe procedura për të njëjtën është si vijon, pala më sjell kontratën mbi shitblerjen e automjetit, fotokopjen e letërnjoftimeve të shitësit dhe blerësit, ndërsa pas kësaj unë vazhdoj me procedimin e mëtutjeshëm dhe ate pagimin e shpenzimeve komunale, gjegjësisht taksave komunale, kontrollin teknik si dhe regjistrimin, kontrata te unë ka ardhur nga pala, konkretisht nga D.Q, i cili pos kontratës për shitje komisionarë, më ka sjellur fotokopjen e letërnjoftimit dhe ate të shitësit dhe të blerësit, librezë e qarkullimit si dhe automjetin, e njoh H..n edhe personalisht.

I akuzuari E.S në shqyrtimin gjyqësor me datën 30.09.2014, në mbrojtjen e vet deklaroi: në muajin mars të vitit 2011 në ... në rrugën ... nr...., shtëpi e këtu të dëmtuarit M.R, është e vërtet që kam marr një automjet të markës “Mercedes”, në oborrin e shtëpisë të njëjtë, të cilën i dëmtuari M.. e ka vlerësuar 12.500 Euro, ndërsa sipas mendimit tim vlere e tij në treg ka qenë 10.000 Euro. Pos kësaj M.. më ka dhënë edhe 3.700 Euro, e po ashtu edhe një komplet të qoshes

të krevatit si dhe një lavatriqe, pak të dëmtuar, në mënyrë që të kenë vlerën prej 4.000 Euro. Pas 3 dite ka ardhur M., dhe ka sjell një automjet të markës “Audi A4” pronë e të dëmtuarit të dytë H.K, dhe më ka ofruar ndërrimin e këtij automjeti me automjetin e markës “Mercedes” me Audin e H., M. ma ka sjell në një punishte ku kam punuar, ngase unë punoj si murator, dhe pasi që kam tentuar që automjetin Audi ta shes, për të hollat që më janë nevojitur për blerjen e materialit ndërtimor, më kanë ofruar 8.000 Euro. Në disa tentime të mija për ta shitur automjetin “Audi A4”, më kanë ofruar më së shumti 8.000 Euro, ndërsa sipas M. vlera e automjetit “Audi A4” ka qenë 11.000 Euro. Pas kësaj unë kam shkuar në depon e I., këtu të akuzuarit të dytë, nga i cili blej material të ndryshëm që më nevojiten për veprimtarin time, dërrasa dhe lëndë-tra, që më nevojiten gjatë ushtrimit të veprimtarisë time. I kam ofruar I., automjetin, duke e pyetur sa ka vlerë ky automjet, dhe a ka vlerë i njëjti shumën prej 11.000 Eurove, të cilën shumë e ka vlerësuar M... I... më ka thënë që nuk e din vlerën e saktë të automjetit, por më ka dhënë 4.000 Euro, para të gatshme, me premtimin që në të ardhmen do të paguaj edhe pjesën e mbetur, por pjesën e mbetur nuk më ka dhënë as sot e kësaj dite, e as nuk më ka kompensuar me ndonjë material që më nevojitet në afarizmin tim, edhe pse dy herë me të dëmtuarin M. kemi shkuar në deponin e I., për të kërkuar mbetjen e çmimit të pagesës, por i njëjti e ka shtyer pagesën të dy herrat, me arsyetim që për momentin nuk ka mjete të nevojshme, fjala është për mjete materiale. Pas kësaj më nuk kam shkuar, rasti është hapur në polici, dhe nga kjo edhe mbahet edhe kjo procedurë gjyqësore këtu në gjykatë. Për shumën të cilën e kam pasur në dispozicion dhe ate 3.700 Euro para të gatshme nga M., si dhe 4.000 Euro nga i akuzuari i dytë Isak, në emër të pjesës së parë të çmimit të shitjes së automjetit, kam kryer këto veprime në ndërtimin të shtëpisë së M., e kam rrënuar objektin e vjetër të shtëpisë, kam gropuar podrumin, në sipërfaqe prej 40 m katror, kam ndërtuar murrët anësore, si dhe kam ngritur pllakën e parë, dhe kam bërë të gatshme fillimin e ndërtimit të katit të parë, për mbulimin e podrumit, e thellësia e podrumit ka qenë 2,50 metra. Unë nuk e kam kërkuar pëlqimin e të dëmtuarit H.K, por i kam besuar M., ngase automjetin kur ma ka dhënë për ndërrim më ka dhënë edhe lejen e qarkullimit të automjetit “Audi A4”, dhe kam parë që automjeti është në emër të H., e për H..n e kam ditur që është shok i M., andaj edhe nuk e kam kontestuar pranimin e automjetit “Audi A4”, Unë kam filluar këtë marrëveshje, me shpresë që të përfundoj punimet, dhe që automjetin “Audi A4”, ta dërgoj dhe ta shes, e si kundër vlerë të marr material ndërtimor, por faktikisht unë dola i dëmtuar në dy mënyra, një anë nga M., e në rastin tjetër edhe nga I... Pllaka e parë është shtruar nga ana ime. Vlera e punëve të kryera ka qenë diku 10.000 Euro. Arsyeja e vërtet e ndërrimit të automjeteve nuk e di, por kur e ka bërë ndërrimin M., krahas ndërrimit automjeteve më ka dhënë edhe shumën e të hollave në vlerë prej 1.500 Euro. Vlera e përgjithshme e mjeteve të punës dhe materialit ndërtimor të mbetur në truallin e shtëpisë në ndërtim të dëmtuarit M., të cilat më kanë mbetur tek M., ka qenë diku rreth 3.500 Euro, të cilat M. i ka marr dhe ja ka shitur një ndërmarrje tjetër ndërtimore, të cilës unë nuk e di. Nuk është e vërtet që I.. më ka dhënë 6.000 euro në emër të kistit të parë të blerjes së automjetit, si dhe nuk është e vërtet që kam marr material ndërtimor te i njëjti në vlerë prej 2.000 euro, unë jam furnizuar me material ndërtimor në një deponi të materialit ndërtimor përfundi deponis te I. i quajtur “...”, dhe aty kam marrur material në vlerë prej 700 euro, të cilën shumë as në ditën e sodit nuk e kam paguar. E përsërisë që unë kam qenë dy herë tek I., së bashku me M., për pagesën e pjesës së mbetur të çmimit të automjetit. I.. më ka kërkuar 5.700 euro për kthimin e automjetit, e mi ka dhënë 4.000 euro, e këtu ka qenë shkaku që nuk ka mundur ta marr automjetin prapa. Arsyeja kryesore e marrjes së automjetit të M. ka qenë ndërtimi i shtëpisë të M... Shtëpia nuk është ndërtuar, ka mbetur e ndërtuar vetëm pllaka e parë si ceka më lart.

I akuzuari I.S, në shqyrtimin gjyqësor me datën 18.12.2014, në mbrojtën e vet deklaron: Ne tersi si ne deklaratën te dhënë ne Prokurori me datën 11.04.2012 , se është e vërtet qe unë i kame dhënë letërnjoftimin e H.K, i cili ka qene pronar i automjetit “Audi A 4”, shokut tim D.Q, për ta bere regjistrimin e automjetit . Automjetin unë e kame blere nga i akuzuari i pare . Automjetin e kam blere te akuzuari i pare E.S , të cilit i kame dhënë 6.000 para te gatshme, si dhe 2.000 Euro i njëjti mi ka pasur borxh mua, kështu qe me këtë jemi barazuar . Theksoi qe unë e kame pyetur E.. a është automjeti i tij, dhe i njëjti me ka thënë qe automjetin e ka marr nga H.K , për te ia kryer një pune , ndërsa pse dhe çfarë pune nuk me ka thënë . Unë për ta barazuar borxhin tim, qe ma kishte E., ne shume prej 2.000 Eurove, i kame dhënë edhe pjesën e mbetur te vlerës prej 8.000 Eurove, sa ka vlefte automjeti dhe pasi qe e kamë marre automjetin, dhe pas pagës se shumes prej 6.000 Eurove, kopjen e letër njoftimit si dhe lejen e qarkullimit te automjetit, ia kame dhënë djalit te motrës sime D.Q, për te ma regjistruar automjetin. Theksoi qe dokumentet e cekura mua mi ka dhënë E.S . Nuk e kame ditur që dokumentet kur ja kam dhënë Dritonit i njëjti ka përpiluar kontratë fiktive në mes meje si blerës dhe H.K si shitës. Ne kohën kur është bërë ky transferim, nuk ka ekzistuar shërbimi i noterisë dhe as nuk me ka interesuar a ka kontrate apo jo. Shuma e përgjithshme ka qene 8.000 Euro , dhe ate 6000 Euro i kame dhënë E.. para te gatshme, ndërsa 2.000 Euro mi ka pasur borxh mua E., çka do te thotë qe shuma e përgjithshme e shitblerjes ka qene 8.000 Euro.

I akuzuari D.Q, në shqyrtimin gjyqësor të datës 18.12.2014, në mbrojtën e vet deklaron: Ne tërësi si ne procesverbalin ne Prokurorin e shtetit me datën 11.05.2012, qe unë e kame marre nga daja im I.S, letërnjoftimin dhe lejen e qarkullimit te automjetit “Audi A 4”, prone e H.K. Letërnjoftimin, fotokopjen e te dëmtuarit H.K, si dhe leja e qarkullimit, kanë qenë në automjet. Unë kame shkuar vet për ta regjistruar automjetin, dhe me të arritur me kane thënë disa persona qe duhet te blejë një kontrate, te cilën gjë unë edhe e kame bërë, për shumën prej 5 Euro . Pas blerjes se kontratës, te njëjtën se bashku me dokumentet përcjellëse dhe atë letërnjoftimin e H.K, dhe lejen e qarkullimit te automjetit Audi A 4 , i kame dorëzuar ne qendrën për regjistrim. Kamë vazhduar punën time te përditshme ne pllacin tim te daja ku punoj, dhe pas diku rreth 2- 3 ore , ma kane sjell automjetin se bashku me lejen e qarkullimit. Unë kame menduar se e tërë procedura është konform ligjit , dhe të kisha ditur qe e tëra kjo do te përfundonte kështu siç po përfundon , nuk do te kisha pranuar te regjistroj automjetin. Unë deklaroj edhe njëherë qe unë personalisht nuk kame nënshkruar kontratën e shitblerjes se automjetit, as ne emër te shitësit H.K, as ne emër te blerësit I.St, unë vetëm i kame dorëzuar dokumentet , ashtu siç ceka me larte, dhe automjetin ma kanë sjell ne plac, ku punoj te daja im. Theksoj qe për regjistrim kame paguar shumen prej 400 Euro , te cilat te holla i kame dorëzuar kur e kame dorëzuar dokumentacionin . Unë nuk di kush e ka plotësuar kontratën, unë vetëm e kame blere kontratën, dhe se bashku me dokumentacionin si dhe te hollat ne shume prej 400 Euro i kame dorëzuar ne Qendrën për regjistrim, e kontrata ka qene vetëm një lloj modeli, e pa plotësuar, e kush e ka plotësuar, dhe si e ka plotësuar unë nuk e di. Kontrata ka qene vetëm ne një vulë e pa plotësuar. Nuk ka pasur kurrfarë shënime tjera.

I akuzuari G.B në shqyrtimin gjyqësor me datën 18.12.2014, në mbrojtën e vet deklaron: Unë qëndroj ne tersi pranë deklaratës te dhënë ne Prokurori, me datën 06.06.2012, edhe një here theksoj këtu para Gjykatës qe ne si kompani këto kontrata i shesim blanko dhe atë ne shume prej 1 Euro, e pas kësaj kompanitë e sigurimeve klientëve ju shesim nga 5 Euro, te njëjtat

kontrata, por te plotësuar, me emra dhe mbiemra te shitësit dhe te blerësit. Në rastin konkret unë nuk e di që kame plotësuar një kontrate, pa prezencën e të dy palëve, apo me fotokopjen e letërnjoftimit të njëres palë që nuk është prezentë. Edhe njëherë theksoj që unë personalisht nuk kame pasur dhe nuk kame qenë në shitblerjen e automjetit te markës Audi A 4, në mes të shitësit H.K dhe blerësit I.S. Gabimi im i vetëm është që kam shitur kontrata bllanko, dhe theksoj që unë nuk kam qenë pronar i kompanisë N.SH. ..., pronar ka qenë i biri im E.B, e unë kam qenë punëtor i tij. Ndërmarrja ... është tani në pushim, dhe për momentin nuk merret me afarizëm. Në ndërmarrje deri sa ka qenë aktive kemi qenë diku 5-6 punëtor varësisht nga nevoja e afarizmit tonë. Nënshkrimin në kontratë e ka vënë personi që e ka plotësuar, ne kur i kemi shitur kontratat të njëjtat i kemi pasur vetëm të vulosura e jo edhe të nënshkruar.

Në shqyrtimin gjyqësor me datën 27.02.2014, është bërë shikimi në ekspertizën e ekspertit për ndërtimtari L.M, lidhur me vlerësimin dhe mendimin për bazën e podrumit të objektit, ekspertizë e përpiluar me datën 10.02.2014, nga e cila është vërtetuar në tërësi gjendja e bazës të podrumit të objektit, dhe është vlerësuar shuma e përgjithshme e para masave me para llogari të punimeve të kryera në rrënimin e shtëpisë së vjetër, rrëmihjen e gropës së podrumit, betonimin e pllakës të themeleve dhe murratimin e mureve të podrumit, e të gjitha këto për vërtetimin e gjendjes faktike të veprimeve të akuzuarit të parë E.S, në kryerjen e veprës penale të mashtrimit nga neni 261 par.1 të KPK-ës.

Në shqyrtimin gjyqësor me datën 10.04.2014, është bërë shikimi në kontratën mbi shitjen komisionarë numër ..., të datës 04.11.2011, të lidhur në mes të ..., si komisionar dhe H.K këtu i dëmtuar nga ... si komitent. E kjo për vërtetimin e gjendjes faktike të veprimeve të akuzuarit G.B në kryerjen e veprës penale rastet e posaçme të falsifikimit e dokumenteve nga neni 333 par.1 të KPK-ës.

Sa i përket vërtetimit të gjendjes faktike të veprimeve të akuzuarve I.S dhe D.Q, në kryerjen e veprës penale legalizimi i përmbajtjes së pavërtetë nga neni 334 par.1 lidhur me nenin 23 të KPK-ës, gjykata këtë e vërtetoj nga deklaratat e të akuzuarve të dhëna gjatë shqyrtimit gjyqësor si në mbrojtjen e tyre ashtu edhe në fjalën përfundimtare.

Gjykata konsideron dhe vjen në përfundim se deklaratat e të akuzuarve E.S, I.S, D.Q dhe G.B, kanë për qëllim shmangien nga përgjegjësia penale, dhe deklaratat e tyre gjykata i konsideron që kanë për qëllim vetëm përjashtimin e përgjegjësisë penale juridike të akuzuarve, duke pasur parasysh që nuk është kontestuese nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, që i akuzuari E.S ka kryer veprën penale të mashtrimit, në atë mënyrë që në fillim të muajit mars të vitit 2011, ka marr obligim që ti ndërtoj shtëpinë të dëmtuarit M.R, dhe si kundër vlerë paraprakisht ka marr një automjet të markës “Audi A4”, pronë e H.K, për ndryshe bashkë punëtor afarist i të dëmtuarit M.R, dhe ate në vlerë prej 12.500 Euro, si dhe ka marr edhe 4.000 Euro të holla të gatshme, mirëpo edhe për kundër shumës të përgjithshme të cekur, të marr në emër të ndërtimit të shtëpisë të dëmtuarit nga ana e të akuzuarit E.S, i njëjti nuk e ka ndërtuar shtëpinë, e kjo shihet edhe nga ekspertiza e ekspertit të ndërtimtarisë L.M, lidhur me punimet e kryera në shtëpinë e të dëmtuarit M.R nga ana e të akuzuarit E.S, automjetin i njëjti e ka shitur të akuzuarit të dytë I.S, dhe ate për një çmimin e shit blerjes prej 8.000 Eurove, ndërsa i ka paguar 6.000 Euro, ndërsa mbetjen prej 2.000 Eurove të çmimit të shit blerjes e ka barazuar me borxhin paraprakë që i akuzuari E.S ja ka pasur të akuzuarit I.Sn. I akuzuari i dytë I.S, automjetin e

markës “Audi A4”, të blerë nga ana e tij prej të akuzuarit E., e ka regjistruar nëpërmjet të djalit të motrës së tij këtu të akuzuarit të tretë D.Q, në atë mënyrë që të njëjtit i ka dhënë letërnjoftimin e të dëmtuarit H.K, dhe ate fotokopjen të njëjtës, si dhe lejen e qarkullimit të automjetit “Audi A4”, që këtu i akuzuari i tretë D.Q, të bëjë regjistrimin e automjetit të cekur në emër të akuzuarit I.S, dhe ate pa pëlqimin e pronarit këtu të dëmtuarit H.K. I akuzuari i tretë D.Q, ka marr fotokopjen e letërnjoftimit të dëmtuarit H.K, si dhe lejen e qarkullimit automjetit “Audi A4”, dhe me këto dy dokumente ka shkuar në Qendrën për regjistrimin e automjeteve dhe pas marrjes të një bllanko kontrate për shitje komisionarë të NSH “...”, të pa vulosur dhe të pa plotësuar, të njëjtën e ka plotësuar në emër të shitësit këtu të dëmtuarit H.K, dhe në emër të blerësit këtu të akuzuarit I.S, të cilën kontratë për shitje komisionare e ka plotësuar dhe vulosur i akuzuari i katërt G.B, dhe i ka dorëzuar në Qendrën për regjistrimin e automjeteve.

Gjykata në tërësi i fali besimin deklaratës të dëmtuarve H.K dhe M.R, deklarata këto që vërtetojnë faktin që i dëmtuari H.K nuk i ka dhënë askujt letërnjoftimin e tij personal, dhe se automjeti i tij është tjetërsuar nga ana e të akuzuarve dhe ate të akuzuarit të dytë I.S, pa vullnetin dhe dëshirën e tij. Po ashtu deklarata e të dëmtuarit M., vërteton gjendjen faktike të përshkruar më lart, dhe ate që i njëjti e ka paguar çmimin e tërësishëm në shumë të përgjithshme prej 16.500 Euro, dhe ate shumën prej 4.000 Eurove të holla të gatshme dhe automjetin e markës “Audi A4”, në vlerë prej 12.500 Euro, në emër të ndërtimit të shtëpisë, këtu të akuzuarit të parë E.S, i cili nuk e ka plotësuar obligimin e marr, e automjetin e marr në emër të kësaj marrëveshje i akuzuari E.. ja ka dhënë të akuzuarit I.S, i cili së bashku me të akuzuarin D.Q, e kanë regjistruar në Qendrën për regjistrimin e automjeteve në emër të akuzuarit I.S, e të cilën kontratë e ka plotësuar dhe vulosur i akuzuari i katërt G.B. Deklaratat e të akuzuarve gjykata nuk ju fali besimin, nga të cekurat më lart, e po ashtu sa i përket parashtrimit të provës nga ana e të akuzuarit të katërt G.B në fjalën e tij përfundimtare, që biznesi dhe ate NSH “...” është në emër të Evhat Baxhakut, për ndryshe birit të tij, dhe ate në bazë të certifikatës të regjistrimit të datës 12.02.2010, gjykata nuk ja fali fare besimin, ngase vepra penale për të cilën akuzohet i akuzuari i katërt është kryer në vitin 2011, dhe vulosjen si dhe nënshkrimin dhe kontratën komisionarë të lidhur me datën 04.11.2011, e ka plotësuar dhe vënë nënshkrimin e personit tjetër këtu të dëmtuarit, pa autorizim, andaj një parashtrim i një prove të tillë në fjalën përfundimtare, vetëm ka pasur për qëllim sipas mendimit të gjykatës vënjen në dyhim të përgjegjësisë penale juridike nga ana e të akuzuarit të katërt G.B, si dhe përjashtimin e tij nga përgjegjësia penale. Nga të cekurat gjykata ka ardhur në përfundim se me veprimet e të akuzuarve formohen të gjitha elementet qenësore të veprave penale të përshkruara si në shqiptim të këtij aktgjykimi, dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarit të shpallen fajtor dhe të gjykohen në bazë të ligjit, duke vërtetuar paraprakisht përgjegjësin e tyre penale juridike.

Me rastin e marrjes të vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPK të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, si rrethanë rënduese gjykata gjeti se veprat penale për të cilat akuzohen këtu të akuzuarit, janë shpeshtuar në masë të madhe kohëve të fundit, e si rrethanë lehtësuese është marrë marrëveshja për kthimin e automjetit, e nënshkruar në mes të akuzuarit të parë E.S dhe të akuzuarit të dytë I.S, e lidhur në shqyrtimin gjyqësor me datë 24.12.2014, pendimi i thellë i të akuzuarve për veprat penale që ju vihen në barë, sjellja korrekte e të akuzuarve pas kryerjes së veprës penale , gjerë më tani të pa gjykuar, çka nënkupton se nuk kanë ardhur ndesh me rregullat pozitive, komform nenit 74 dhe 75 të KPK gjykata mori parasysh rrethanat personale dhe

karakterin e të akuzuarve, të cilët në momentin e kryerjes së veprës kanë qenë në moshë relativisht të re, kanë bashkëpunuar vullnetarisht me gjykatën, keqardhjen e shfaqur si dhe kanë pasur sjellje korrekte pas veprës penale të kryer andaj gjykata ju shqiptoi dënimin me kusht sepse konsideron se edhe me kërcënim të dënimit do të arrihet qëllimi i dënimit, prandaj i shqipton të akuzuarve secilit veç e veç dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 2 (dy) viteve, të akuzuarit nuk kryejnë veprë të re penale, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tyre dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të janë më të kujdesshëm dhe do të përmbahen nga veprimet e tilla.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe të paushallit gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 dhe 451 të KPPK-ës.

Vendimin mbi udhëzimin e të dëmtuarit në kontest civil gjykata e bazoi në kuptim të nenit 463 të KPPK.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
PKA.nr.112/2012 të datës 29.12.2014

Procesmbajtësja
Shukran Celina

Gjyqtari
Luan Berisha

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.